

V E N D I M
Nr. 180, datë 13.4.2000

**PËR SHPALLJEN ANSAMBËL MONUMENT- KULTURE TË AKSIT KRYESOR DHE
QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 16, të ligjit nr.7867, datë 12.10.1994, “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpallet “Ansambël monument-kulture”, aksi qendror dhe qendra historike e qytetit të Tiranës, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e këtij ansambli janë: Nga sheshi përpara stacionit të trenit, përgjatë shtëtitores “Dëshmorët e Kombit”, deri prapa hotel Tiranës”. Vazhdon përgjatë rrugës “U. Pano”, deri në kryqëzimin me “Rrugën e Barrikadave”. Përgjatë “rrugës së Barrikadave”, deri në kryqëzimin e saj me rrugën “Punëtorët e Rilindjes”. Përgjatë rrugës “Punëtorët e Rilindjes” deri tek “Ura e Tabakëve”. Përgjatë bulevardit “Zhan D’Ark” deri tek ura e “Rrugës së Elbasanit”. Kalon urën dhe vazhdon në bulevardin “Bajram Curri” deri në kryqëzimin me rrugën “Lek Dukagjini”. Përgjatë rrugës “Lek Dukagjini” deri te stadiumi “Qemal Stafa”. Përgjatë rrugës që përfshin stadiumin “Qemal Stafa”, duke përfshirë 100 m thellësi në jug të rrugës përpara Universitetit Politeknik, deri te sheshi përpara Gardës së Republikës. Nga sheshi përpara Gardës së Republikës, përgjatë rrugës “Dëshmorët e 4 shkurtit” deri në kryqëzimin me “Rrugën e Kavajës”. Përgjatë “Rrugës së Kavajës” deri te sheshi në krah të “Lidhjes së Shkrimtarëve”. Nga ky shesh përgjatë rrugës “Kajo Karafili” deri në kryqëzimin me rrugën “Ded Gjo Luli”. Përgjatë rrugës “Ded Gjo Luli” deri në daljen në shëtitoren “Dëshmorët e Kombit”. Përgjatë shëtitores “Dëshmorët e Kombit” deri te sheshi përpara stacionit të trenit.

3. Të gjitha ndërtimet e përkohshme apo të përhershme, të paligjshme, të hiqen brenda fundit të vitit në vazhdim, sipas një plani të specifikuar ndërhyrjeje.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Punëve Publike që, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të realizojnë projektin për ruajtjen dhe restaurimin e elementeve përbërës të ansamblit të mësipërm, në përgjithësi.

5. Për bashkërendimin dhe zbatimin e këtij projekti krijohet grupi i punës, me 3-5 anëtarë, të cilët caktohen nga Kryeministri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta